



Prishtinë, 06 prill 2020
Kodi i ZRRE-së: V_1242_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, neni 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084),
- Nenin 16 paragrafin 5 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja, e miratuar me dt. 11.11.2014 nga Bordi i ZRRE-së,
- Vendimin për lëshimin e Autorizimit Final V_881_2017 të datës 09 shkurt 2017 për shoqërinë "Eurokos JH" SH.P.K. për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Brodi 1, në Lumin Brod ZK Brod, komuna e Dragashit, dhe
- Kërkesën për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit për Autorizimin Final V_881_2017 të datës 09 shkurt 2017 i Modifikuar me Vendimin V_1054_2018 edhe për një (1) vit, për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Brodi 1, në Lumin Brod ZK Brod, me kapacitet të instaluar prej 2.48 MW, komuna e Dragashit, të datës 07.02.2020 nr. prot. 083/20 të shoqërisë "Eurokos JH" SH.P.K. me adresë: rr. "Migjeni" nr. 23, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, dhe

në seancën e mbajtur me datë 06 prill 2020 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa e shoqërisë "Eurokos JH" SH.P.K., dhe **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Autorizimit FINAL V_881_2017 të datës 09 shkurt 2017 i Modifikuar me Vendimin V_1054_2018 i të datës 15 tetor 2018 dhe Vendimin V_1114_2019 të datës 28 shkurt 2019 për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Brodi 1, në Lumin Brod ZK Brod, me kapacitet të instaluar prej 2.48 MW, komuna e Dragashit, edhe për një (1) vit.

A r s y e t i m

- o ZRRE me datë 27.03.2015 nga shoqëria "Eurokos JH" SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese nga Hidrocentrali, në Lumin Brod, HC Brod 1 me kapacitet të instaluar prej 1.06 MW ZK Bord, komuna e Dragashit, Republika e Kosovës.



- Bordi i ZRRE-së, pas konstatimit se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali, me datë 28 janar 2016 dhe ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar Nr. V_767_2016 dhe ka udhëzuar aplikuesin që t'i plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- ZRRE me datë 16.01.2016 nga shoqëria "Eurokos JH" SH.P.K., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim FINAL për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Hidrocentrali në Lumin Brod, HC Brod 1 me kapacitet të instaluar prej 1.06 MW ZK Bord, komuna e Dragashit, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore dhe ujore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, Lejen Ndërtimore të lëshuar nga komuna dhe kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- Bordi i ZRRE me datë 09 shkurt 2017 ka lëshuar Vendimin për Autorizimin Final V_881_2017 shoqërisë "Eurokos JH" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali në rrjedhën e Lumit Brod me kapacitet të instaluar prej 1.06 MW, ZK Brod, komuna e Dragashit.
- ZRRE me datë 27 shtator 2018 nga shoqëria "Eurokos JH" SH.P.K., ka pranuar kërkesën për Modifikimin e Autorizimit Final V_881_2017 të datës 09 shkurt 2017, për Modifikimin/ndryshimin e kapacitetit instalues nga 1.06 MW në kapacitetin total instalues prej 2.48 MW për Hidrocentralin HC Brodi 1 që është duke u ndërtuar në ngastrën kadastrave nr. 1339 ZK Brod, komuna e Dragashit.
- Bordi i ZRRE-së, me datë 15 tetor 2018 ka vendosur me Vendimin V_1054_2018 për Modifikimin e Vendimit të Autorizimit Final V_881_2017 të datës 09 shkurt 2017, lëshuar shoqërisë "Eurokos JH" SH.P.K., për Hidrocentrali HC Brodi 1 nga kapaciteti instalues prej 1.06 MW në kapacitetin total instalues prej **2.48 MW** ngastrë kadastrave nr. 1339 ZK Brod sipas Vendimit nr. 783/18 – ZSP- 1088/2018 të datës 12.09.2018 për ndryshimin e vendimit të Lejes së Ujore me Nr. 1782 - 2/11 – ZSP- 620/12 dt. 23.08.2012 për HC Brodi 1, nga N=1.062 MW në N=2.48 MW në segmentin ujqor, nga Kuota 1355.41 ml.m, deri në Kuotën 1251.0 m.l.m., të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).
- ZRRE me datë, 01.02.2019 nga shoqëria "Eurokos JH" SH.P.K., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së Vendimit për Autorizimin FINAL V_881_2017 të datës 09 shkurt 2017, për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali HC Brodi 1, ZK Brod me kapacitet të instaluar prej 2.48 MW, edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri me 09 shkurt 2020 për finalizimin e projektit.
- Bordi i ZRRE-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 28 shkurt 2019, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesës dhe dëshmimeve relevante, ka aprovuar kërkesën e shoqërisë "Eurokos JH" SH.P.K., me vendimin V_1114_2019 ka vendosur të shtyhet afati i vlefshmërisë të vendimit për autorizimin Final V_881_2017 të datës 09 shkurt 2017 edhe për një (1), në pajtim me dispozitat ligjore të Rregullës për procedurën e autorizimit.



- ZRRE me datë, 07.02.2020 nga shoqëria "Eurokos JH" SH.P.K., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së Vendimit për Autorizimin FINAL V_881_2017 të datës 09 shkurt 2017, për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali HC Brodi 1, ZK Brod me kapacitet të instaluar prej 2.48 MW, edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri me 09 shkurt 2021 për finalizimin e projektit.
- Shoqëria "Eurokos JH" SH.P.K., në kërkesën e saj ka theksuar se: që nga data e pranimit të vendimit për Autorizim Final të Bordit të ZRRE-së, kanë filluar përgatitjet për fillimin e punimeve në ndërtimin e Hidrocentralit HC Brodi 1, duke filluar me matjet gjeodezike nga ekspertët e fushës, hapja e rrugës, traseja e tubacionit dhe ndërtesa e hidrocentralit.
- Shoqëria "Eurokos JH" SH.P.K., në kërkesën e saj po ashtu ka sqaruar se, janë duke punuar intesivisht në teren edhe përkundër vështirësive në realizimin e projektit HC Brodi 1, ku deri më tani janë përfunduar punimet në hapjen e trasesë për vendosjen e tubacionit, janë vendosur/montuar tubacionet, është përfunduar vepra e marrjes, është në ndërtim ndërtesa e hidrocentralit, janë duke u përfunduar punimet në largpërçuesin e cila është duke u finalizuar sipas pëlqimit elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS, dhe nga kjo situatë kanë siguruar se janë përfunduar më shumë se 80% të punëve në terren.
- Shoqëria "Eurokos JH" SH.P.K., ka sqaruar se arsyeja e shtyrjes së afatit për periudhën një vjeçare, është se kanë të bëjnë me një terren të vështirë, ku ka rrëshqitje të dheut nga uji, moti i papërshtatshëm për zhvillimin e punëve normale në periudhën e dimrit dhe pranverës, ku është dashur të punohet me kujdes e herë herë edhe të ndalohen punimet për të evituar edhe pasojat, për shkak të specifikave të terrenit dhe specifikave të projektit, ku janë detyruar që të jenë të kujdesshëm pasi që vlera e projektit është e madhe dhe rreziqet është dashur të kihet parasysh, dhe që të gjitha këto kanë shkaktuar vonesa në përfundimin e këtij projekti deri më tani, e për të cilën kanë kërkuar edhe shtyrje të afatit për finalizimin e këtij projekti.
- Andaj, bazuar në të gjitha ato që u paraqitën më lartë, shoqëria "Eurokos JH" SH.P.K., ka kërkuar nga Bordi i ZRRE-së, që duke u mbështetur në dispozitat ligjore të Nenit 16 par. 5 të Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, t'iu lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit FINAL V_881_2017 të datës 09 shkurt 2017, për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga hidrocentrali HC Brodi 1 edhe për një (1) vit, pasi që vonesat për përfundimin e projektit kanë ardhur nga arsyet e cekura më lartë, dhe brenda këtij afati do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të finalizuar projektin.
- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së shoqërisë "Eurokos JH" SH.P.K., dhe dëshmive të bashkangjitura për shtyrje të afatit të vlefshmërisë të Autorizimit Final, për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Brodi 1, në Lumin Brod ZK Brod, me kapacitet të instaluar prej 2.48 MW, komuna e Dragashit, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se arsyeshmëria e kërkesës së aplikuesit është e bazuar, dhe duke u mbështetur në shkresat e lëndës, ku janë prezantuar fakte se brenda kësaj periudhe do të finalizohet projekti, ka vendosur që të lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final




V_881_2017 i datës 09 shkurt 2017, edhe për një afat shtesë ligjor, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi.

- II. Vendimi për Lëshimin e Autorizim Final V_881_2017 i datës 09 shkurt 2017, do të vlen deri me datë 09 shkurt 2021, sipas dispozitivin nën pikën I., të këtij vendimi, dhe në rast se nuk arrin të përfundoj ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese nga Uji, apo nuk vepron në pajtim me legjislacionin në fuqi, vendimi do të shfuqizohet.
- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janova, u.d. kryesues


Besim Serhija, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Dragashit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MIA-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.